



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1491/14 prot.

Datë 15.10.2021

**V E N D I M**  
**Nr. 770/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                  |            |
|------------------|------------|
| Jonaid Myzyri    | Kryetar    |
| Fiorent Zguro    | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar     |
| Anila Malaj      | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 15.10.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Almedical” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-98424-06-17-2021, me objekt: “*Blerje tuba dhe materiale konsumi për marrjen e kampioneve të gjakut për nevoja të QSUNT për 12 muaj*”, me fond limit 15.941.052,5 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Almedical” SHPK  
Rruga “Shefqet Musaraj”, Banesa nr.17, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”  
Rruga e Dibrës, Nr. 372, Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020  
“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin  
e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit  
Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -  
19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 18.06.2021 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-98424-06-17-2021, me objekt: “Blerje tuba dhe materiale konsumi për marrjen e kampioneve të gjakut për nevoja të QSUNT për 12 muaj”, me fond limit 15.941.052,5 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 09.08.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

|  |                                   |
|--|-----------------------------------|
| 1. “Almedical” SHPK                            | 6.461.800 lekë, skualifikuar      |
| 2. “Distributor of Medical Devices Group” SHPK | 6.592.900 lekë, kualifikuar       |
| 3. “Laser - Med” SHPK                          | 6.927.200 lekë, skualifikuar      |
| 4. “Gamma” SHPK                                | 7.222.000 lekë, kualifikuar       |
| 5. “Fedos” SHPK                                | 7.859.300 lekë, kualifikuar       |
| 6. “Swissmed” SHPK                             | 9.855.400 lekë, kualifikuar       |
| 7. “Krijon” SHPK                               | 12.080.500 lekë, kualifikuar      |
| 8. “Biometric Albania” SHPK                    | Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

II.3. Operatori ekonomik “Almedical” SHPK është njoftuar për arsyet e skualifikimit të tij si më poshtë vijon:

*“Ne procesverbalin e dorëzimit të monstrave OE ALMEDICAL ShPK me NUIS K21511002I në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” në artikullin nr.2 “Tuba me xhel për serum me aktivator koagulimi të shpejte. Sistem i mbyllur me vakum. Tape e verdhe/ e kuqe”, OE ka paraqitur monster me tape portokalli duke mos përmbushur specifikimin teknik të kerkuar në DST. Kjo gjë pasqyrohet edhe në Katalogun e paraqitur në SPE.*

*Referuar shtojcës 7, pika 2.3/b të DST citohet: “Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuar sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet”, duke mos e përmbushur specifikimin teknik të kerkuar në piken e sipërcituar. Për këto arsye dhe sa me sipër, në zbatim të Nenit 92/3 të LPP, oferta e paraqitur nga OE Almedical ShPK., skualifikohet pasi artikujt e ofruar nuk plotësojnë specifikimet teknike të kerkuara në DST.*

II.4. Në datën 11.08.2021, është publikuar njoftimi i fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe në datë 16.08.2021 është publikuar njoftimi i fituesit në Buletinin Nr.122 datë 16 Gusht 2021, prej të cilës rezulton fitues operatori ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK.

II.5. Në datën 16.08.2021, operatori ekonomik “Almedical” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprahe” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të

procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1491/2 date 17.08.2021, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Almedical” SHPK, për të cilat ngrihen pretendime.

II.7. Me shkresën nr. 2178/6 prot, datë 20.08.2021 me objekt: *“Kthim përgjigje mbi formularin e ankesës të administruar pranë autoritetit kontraktor me Nr.2178 prot., datë 16.08.2021 nga OE “Almedical” ShPK”*, protokolluar me tonën me nr. 1491/3 prot datë 23.08.2021, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik përgjigja e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Almedical” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.8. Në datën 01.09.2021 nëpërmjet shkresës nr.1491/4 prot., me objekt: *“Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Almedical” SHPK”*, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor, që krahas dokumentit të sipërcituar, të paraqesë informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimi, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “Almedical” SHPK, si dhe një CD me të gjithë materialet e paraqitura nga shoqëritë pjesëmarrëse. Gjithashtu, krahas informacionit të mësipërm, KPP kërkoi nga autoriteti kontraktor të dorëzojë pranë KPP-së mostrat e paraqitura për këtë procedurë prokurimi, nga operatori ekonomik “Almedical” SHPK, si dhe dokumentacionin shoqëruar të tyre.

II.9. Në datën 10.09.2021, me shkresën nr. 2178/9 prot. datë 07.09.2021, protokolluar me tonën me nr. 1491/5 prot., datë 10.09.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe mostrat e paraqitura në këtë procedurë prokurimi nga operatori ekonomik “Almedical” SHPK. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni u konstatua se autoriteti kontraktor, gabimisht kishte dorëzuar mostrat e një operatori tjetër ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi. Për këtë arsye Komisioni i Prokurimit Publik, me anë të shkresës Nr.1491/2 prot., datë 07.10.2021 i kërkoi autoritetit kontraktor të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik “Almedical” SHPK, si dhe një përfaqësues i autoritetit kontraktor të paraqitej pranë KPP për të tërhequr mostrat e dorëzuara gabimisht të një operatori tjetër ekonomik pjesëmarrës në procedurë.

II.10. Në datën 16.09.2021, me shkresën nr. 1491/6 prot. datë 16.09.2021, Komisioni i Prokurimit Publik, ka vënë në dijeni palët në proces se, referuar nenit 115 pika 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, për shkaqe të nevojshme për verifikim, në përputhje me dispozitën e sipërcituar, nuk është e mundur dalja me një vendim përfundimtar brenda afatit prej 30 ditësh nga ardhja e informacionit të autoritetit kontraktor.

II.11. Në datën 16.09.2021, me anë të shkresës nr. 1491/7 prot., Komisioni i Prokurimit Publik, i ka kërkuar institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit informacionin si më poshtë: *“Në kuadër të shqyrtimit të një ankese, gjatë veprimtarisë tonë, lind e nevojshme ndihma juaj, nëpërmjet informacionit për sa i përket standardit SSH EN*

*ISO 6710:2017 “Enë njëpërdorimshme për mbledhjen e mostrave të gjakut njerëzor”. Konkretisht, a duhet ti referohemi këtij standardi për produktin “Tuba me xhel për serum me aktivator koagulimi të shpejtë. Sistem i mbyllur me vakum. Tapë e verdhë/ e kuqe”?*  
*Nëse po, kërkojmë të na ndihmoni duke na vënë në dispozicion përmbajtjen e këtij standardi, për sa i përket kërkesave dhe specifikimeve teknike që duhet të përmbushin produktet objekt i këtij të fundit.”*

II.12. Me shkresën nr. 253/1 prot. datë 29.09.2021, protokolluar me tonën me nr. 1491/9 prot., datë 30.09.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik përgjigja e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, e cila informon se “[...] Ky produkt duhet ti referohet dokumentacionit shoqërues të vetë produktit nga prodhuesi. Konkretisht tek ky dokumentacion shoqërues përcaktohet kategoria e së cilës ky produkt i përket. Kategoria e produktit, njëkohësisht, përcaktohet nga Direktiva Evropiane si dhe legjislacioni vendas. Gjithashtu duhet ti referoheni dokumentacionit të prodhuesit të këtij produkti, në lidhje me certifikatën CE të konformitetit si dhe standardet që ky produkt plotëson. Pra i duhet bërë referencë certifikimeve të produktit. Bazuar në kërkesën tuaj, për vënien në dispozicion të përmbajtjes së këtij standardi, bashkëlidhur po ju dërgojmë përmbajtjen e plotë (si Dokument Pune) të standardit SSH EN ISO 6710:2017, tek i cili do të gjeni përcaktimet dhe referencat për sa i përket termave në përdorim; enë, tub, aksesori, mostër, mbyllës i enës si dhe kodet e rekomanduara të ngjyrës parësore për identifikimin e aksesorëve (komponentëve dhe mbyllësve në brendësi të enës) për mbledhjen e mostrave të gjakut (Aneksi F i standardit).”

II.13. Në datën 01.10.2021, me anë të shkresës nr. 1491/10 prot., Komisioni i Prokurimit Publik, i ka kërkuar autoritetit kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, informacionin si më poshtë: “Me qëllim gjykimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Almedical” SHPK, duke qenë se, si organi përgjegjës për procedurën e prokurimit, është përgjegjësi e juaja hartimi i kritereve dhe specifikimeve teknike të nevojshme, kërkojmë nga ana juaj të na sqaroni në lidhje me këto specifikime teknike si më poshtë:

1. Cili është dallimi midis dy produkteve të kërkuara nga ana juaj “1. Tuba me xhel për serum me aktivator koagulimi. Sistem i mbyllur me vakum” dhe “2. Tuba me xhel për serum me aktivator koagulimi të shpejtë. Sistem i mbyllur me vakum”? Në lidhje me tubin e dytë, a është ky tub për aktivizues mpiksje trombine”?

2. Gjithashtu, kërkojmë nga autoriteti juaj kontraktor, të na informoni se në cilin standard kombëtar ose ndërkombëtar jeni bazuar në përcaktimin e kodit të ngjyrave për dy produktet e nësipërme.”

II.14. Me anë të shkresës nr. 2178/13 prot. datë 05.10.2021, protokolluar me tonën me nr. 1491/11 prot., datë 07.10.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik përgjigja e autoritetit kontraktor në lidhje me kërkesën e mësipërme. Konkretisht autoriteti kontraktor informon se “Në lidhje me pikën e parë të kërkesës tuaj për sa i përket dallimit mes dy produkteve të mësipërme, ju bëjmë me dije se referuar edhe në specifikimet teknike (shtojca 5) të përcaktuar në DST për këtë procedurë prokurimi në tabelën përkatëse për këto dy artikuj (tek shënimet) dallimi thelbësor mes tyre qëndron tek koha e koagulimit, ku të njëra është jo më shumë se 30 minuta dhe tek tjetra jo më shumë se 10 minuta (koagulimi i shpejtë),

*pasi kjo ndikon në kohën e realizimit të analizave urgjente të një kohe më të shkurtër. Në lidhje me tubin e dytë me aktivator koagulimi të shpejtë ju bëjmë me dije se aktivizuesi mund të jetë çdolloj aktivizuesi i cili bën koagulimin në jo më shumë se 10 minuta.*

*Në lidhje me pikën e dytë të kërkesës tuaj, sqarojmë se përcaktimi i ngjyrave të tapës së tubave të gjakut është bërë në zbatim të një standardi i cili si një trend evropian në të gjithë vendet ka për qëllim diferencimin e tubave me anë të ngjyrave për lehtësimin e punës së stafit mjekësor. AK në DST e publikuara në SPE për këtë procedurë prokurimi në janë përcaktuar specifikimet teknike për të gjithë artikujt e kërkuar objekt prokurimi. Në kërkesat për kualifikim është kërkuar për ofertuesit pjesëmarrës “Autorizim të lëshuar nga firma prodhuese ose distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi/MAH/ (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin)”, ku për firmën prodhuese për artikujt janë kërkuar të paraqiten katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull. Gjithashtu për firmën prodhuese të artikujve është kërkuar autodeklaratë për materialet mjekësore për konformitetin me normat MDD 93/42/EEC (të përditësuar) ose 98/79 EC (të përditësuar), ose EU 2016/425 (të përditësuar) ose FDA ose (EU) 2017/745, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Evropës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklaratë konformiteti) ose FDA [...] si dhe konform standardeve të cilësisë ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose EN ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” ose SSH EN ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, të vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit [...].”*

II.15. Në datën 08.10.2021, me shkresën nr. 2178/16 prot. datë 08.10.2021, protokolluar me tonën me nr. 1491/13 prot., datë 08.10.2021, me objekt “Përcjellim mostrat e operatorit ekonomik “Almedical” SHPK në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje tuba dhe materiale konsumi për marrjen e kampioneve të gjakut për nevoja të QSUNT për 12 muaj”, autoriteti kontraktor ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik mostrat e paraqitura në këtë procedurë prokurimi nga operatori ekonomik “Almedical” SHPK.

II.16. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

## Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Almedical” SHPK se arsyeja e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike “*Ne procesverbalin e dorezimit të mostrave OE ALMEDICAL ShPK me NUIS K21511002I në shtojcën 5 ”Formulari i specifikimeve teknike” në artikullin nr.2 ”Tuba me xhel për serum me aktivator koagulimi të shpejte. Sistem i mbyllur me vakum. Tape e verdhe/ e kuqe”, OE ka paraqitur mostër me tape portokalli duke mos përbushur specifikimin teknik të kërkuar në DST. Kjo gjë pasqyrohet edhe në Katalogun e paraqitur në SPE.*

*Referuar shtojcës 7, pika 2.3/b të DST citohet: ”Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet”, duke mos e përbushur specifikimin teknik të kërkuar në pikën e sipërcituar. Për këtë arsye dhe sa me sipër, në zbatim të Nenit 92/3 të LPP, oferta e paraqitur nga OE Almedical shpk., skualifikohet pasi artikujt e ofruar nuk plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara në DST” nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në shtojcën 7 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pika 2.3.b të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

*b) Për të gjithë artikujt e ofertuar, duhet të paraqiten mostra ditën e hapjes së ofertave, me datë 08.07.2021 në orën 10:00.*

*Dorëzimi i kampioneve/ mostrave, të bëhet pranë Drejtorisë Juridike / Sektori Prokurimeve, QSUT “Nënë Tereza”, të mbyllura në një zarf /kuti jo transparente të vulosur mbi të cilin të shenohet:*

- “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit « ..... » dhe jo para datës \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2021, ora \_\_\_\_ : \_\_\_\_.*
- Se bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.*
- Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënojë Nr.Rendor të Artikullit që përfaqëson.*

*Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.*

III.1.2. Në shtojcën 5 “*Formulari i specifikimeve teknike*” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

| Nr. | Emertimi   | Volumi, permasat      | Shenime   |
|-----|--|-----------------------|---|
| 1   | <i>Tuba me xhel për serum me aktivator koagulimi. Sistem i mbyllur me vakum. Tape e verdhe/ e kuqe</i> | <i>5ml, 13*100 mm</i> | <i>Ndares me silica xhel , koha e koagulimit jo me shume se 30 minuta</i> |
| 2   | <i>Tuba me xhel për serum me</i>   | <i>5ml, 13*100 mm</i> | <i>Ndares me silika xhel,</i>   |

|    |   |  |  |
|----|---|--|--|
|    | <i>aktivator koagulimi te shpejte. Sistem i mbyllur me vakum. Tape e verdhe/ e kuqe</i>                               |  | <i>koha e koagulimit jo me shume se 10 minuta</i>  |
| 3  | <i>Tuba me K2 EDTA per teste hematologjike. Sistem i mbyllur me vakum. Tape Lejla</i>                                 | <i>3-4ml, 13*75 mm</i>   |  |
| 4  | <i>Tuba me K3 EDTA . Sistem i mbyllur me vakum. Tape Lejla</i>  | <i>3-4ml, 13*75 mm</i>   |  |
| 5  | <i>Tub me Trisodium Citrate Plasma (0,109 M, 3.2%) per teste koagulim. Sistem i mbyllur me vakum. Tape Bojeqielli</i> | <i>2.7-4.5 ml, 13*75 mm</i>                                    |  |
| 6  | <i>Tub Sodium Citrate per matjen e eritrosedimentacionit (ESR).</i>   | <i>1,6-5ml</i>   | <i>Te shoqerohet me stativ mbajtes/ aparat mates per matjen jo te me paket se 60 ESR ne ore</i>  |
| 7  | <i>Tuba me Lithium Heparine per plazem. Sistem i mbyllur me vakum. Tape Jeshile</i>                                   | <i>3-4ml, 13*75 mm</i>   | <i>Ndares me xhel ose ndares mekanik</i>   |
| 8  | <i>Tuba ACD (Acid Citrate Dextrose)</i>   | <i>8-10ml, 16*100 mm</i>                                       | <i>Sasi e vogel vetem per HLA</i>  |
| 9  | <i>Shiringe per marrje gjaku me lithium heparine per te testuar gazet ne gjak</i>                                     | <i>1-3 ml 21-22G</i>   | <i>E pershtateshme per te testuar gazet ne gjak</i>  |
| 10 | <i>Set Age fluturper marrje gjaku te pershtateshme per te gjitha tubat e sistemit me vakum te ofruar</i>              | <i>21 G, 19-20 mm, gjatesia e tubit jo me e vogel se 17 cm</i> | <i>Rekomandohen sisteme te ages me kapuc per te shmangur kontaminimin dhe me buton terheqes se ages per mbrojtjen e personelit nga shpimi aksidental</i> |
| 11 | <i>Set Age per marrje gjaku, te pershtateshme per te gjitha tubat e sistemit me vakum te ofruar</i>                   | <i>21 G, 32-40 mm</i>  | <i>Rekomandohen sisteme te ages me kapuc per te shmangur kontaminimin dhe me buton terheqes se ages per mbrojtjen e personelit nga shpimi aksidental</i> |

*Specifikimet teknike te pergjithshme:*



- Afati i Skadences: Data e skadencës për materialet mjekësore objekt prokurimi, në ditën e lëvrimin të mallit duhet të jetë jo më e vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës / ose jo më pak se një vit nga data e lëvrimin të mallit.
- Të gjithë artikujt në tabelën më sipër, të paraqiten mostra.
- Materialet Mjekësore duhet të jenë të markuara CE ose FDA
- Autodeklarate për materialet mjekësore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat MDD 93/42/EEC (të përditësuar) ose 98/79 EC (të përditësuar), ose EU 2016/425 (të përditësuar) ose FDA ose (EU) 2017/745, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Evropës, bashkelidhur me kopjet e certifikatave perkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.
- Autorizim nga MAH / prodhuesi ose distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi.
- Katalogë origjinal ose të noterizuar (të perkthyer në gjuhën shqipe) për të gjithë artikujt dhe të markohen artikujt që ofrohen.
- Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimet për çdo artikull.

III.1.3. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues “Almedical” ShPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku deklarohet përmbushja e specifikimeve teknike dhe grafikut të realizimit të objektit të kontratës.
- Deklaratë e operatorit ekonomik “Almedical” SHPK mbi origjinën e mallit për artikujt objekt prokurimi;
- Ofertë teknike ku pasqyrohen Emri i kompanisë prodhuese; Origjina e mallit; Skadencia e mallit; Emërtimi i katalogut të artikullit/produktit; Nr. I faqes ku ndodhet produkti; Numri i referencës së artikullit; Certifikimet përkatëse;
- Katalog “Vacusera” me prodhues Disera, Turqi.

III.1.4. Në nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.1.5. Në nenin 40 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

*6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

*a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 38 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;*

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.7. Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit rezulton, se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë ofertues, për të gjithë artikujt e ofertuar, duhet të paraqesin mostra ditën e hapjes së ofertave, me datë 08.07.2021 në orën 10:00. Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

III.1.8. Operatori ekonomik ankimes në ankesën e tij pretendon se “[...]Kompania jonë ka prezantuar artikullin nr.2 me specifikimet teknike si më poshtë: Tub 5 ml me xhel serum dhe trombinë – ngjyrë portokalli. Elementi i trombinës shërben për kolaugimin e shpejtë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Dy artikujt e parë të cilët janë kërkuar nga autoriteti kontraktor shërbejnë për të njëjtin funksion por me kohë koagulimi të ndryshme. Pikërisht prania e trombinës bën diferencimin e këtyre dy artikujve dhe ngjyra portokalli shërben për të treguar praninë e trombinës. Kompania jonë pas njohjes me arsyet e skualifikimit kontaktoi me prodhuesin i cili deklaroi që tapat e tubave mund të vendosen sipas ngjyrave që kërkon përdoruesi por ngjyrat e tapave që kanë dërguar si mostra dhe në katalog janë sipas udhëzimeve dhe standardeve ndërkombëtare. (bashkëngjitur gjeni deklaratën). Sipas udhëzimeve ndërkombëtare për prodhimin e tubave për marrjen e mostrave të gjakut, tubat me xhel me aktivator duhet të kenë ngjyrë të verdhë por nëse përmbajnë thrombinë ngjyra e tapës duhet të jetë ngjyrë portokalli (bashkëngjitur gjeni Aneksin e standardit ISO 6710:2017 “Kontejnerë njëpërdorimësh për mbledhjen e mostrave të gjakut venoz të njeriut” mbi përdorimin e ngjyrave të tapave për tubat me xhel që shërbejnë për marrjen e mostrave. Ky standard ISO 6710:2017 i cili është aprovuar nga CEN (Komuniteti Evropian i Standardizimit) zbatohet edhe në vendin tonë sipas publikimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, Shqipëri të cilin e gjeni në linkun: [https://dps.gov.al/sq/katalogu-i-standardeve-shqiptare-2021\\_p10025.html](https://dps.gov.al/sq/katalogu-i-standardeve-shqiptare-2021_p10025.html) dhe në dokumentin bashkëngjitur”.

III.1.9. Nisur nga arsyeja e skualifikimit, si dhe referuar pretendimeve të ankimesit, argumentave të sjellë nga autoriteti kontraktor si dhe nga shqyrtimi i mostrave të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes, KPP konstatoi se ky i fundit për artikullin nr.2 “Tuba me xhel për serum me aktivator koagulimi të shpejtë. Sistem i mbyllur me vakum. Tapë e verdhë/e kuqe”, të përcaktuar në Shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, ka paraqitur mostër “Vacusera CAT Serum Gel & Thrombin”, me tapë ngjyrë portokalli.

III.1.10. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, argumentet dhe faktet e paraqitura nga ky i fundit bashkëlidhur ankesës së dorëzuar njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, KPP iu drejtua institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit duke i kërkuar “...informacion për sa i përket standardit SSH EN ISO 6710:2017 “Enë njëpërdorimësh për mbledhjen e mostrave të gjakut njerëzor”. Konkretisht, a duhet ti referohemi këtij standardi për produktin “Tuba me xhel për serum me aktivator koagulimi të shpejtë. Sistem i mbyllur me vakum. Tapë e verdhë/ e kuqe”? Nëse po, kërkojmë të na ndihmoni duke na vënë në dispozicion përmbajtjen e këtij standardi, për sa i përket kërkesave dhe specifikimeve teknike që duhet të përmbushin produktet objekt i këtij të fundit”.

Ndërkohë Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit i ka kthyer përgjigje kërkesës tonë duke informuar se “[...] Bazuar në kërkesën tuaj, për vënien në dispozicion të përmbajtjes së këtij standardi, bashkëlidhur po ju dërgojmë përmbajtjen e plotë (si Dokument Pune) të standardit SSH EN ISO 6710:2017, tek i cili do të gjeni përcaktimet dhe referencat për sa i përket termave në përdorim; enë, tub, aksesori, mostër, mbyllës i enës si dhe kodet e rekomanduara të ngjyrës parësore për identifikimin e aksesoreve (komponentëve dhe mbyllësve në brendësi të enës) për mbledhjen e mostrave të gjakut (Aneksi F i standardit).”

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit dhe verifikimit të informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, konstaton se në

aneksin F të standardit SSH EN ISO 6710:2017 *“Enë njëpërdorimshe për mbledhjen e mostrave të gjakut njërëzor”*, pasqyrohen kodet e rekomanduara të ngjyrave për identifikimin e aditivëve dhe aksesorëve. Konkretisht në këtë standard përcaktohet se për aktivizues koagulimi me xhel rekomandohet ngjyra e verdhë e errët, por po në këtë përcaktim sqarohet se për aktivizues mpiksje trombine rekomandohet ngjyra portokalli.

Sa më sipër, KPP me qëllim gjykimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes, iu drejtua autoritetit kontraktor duke i kërkuar informacion se *“...Cili është dallimi midis dy produkteve të kërkuara nga ana juaj “1. Tuba me xhel për serum me aktivator koagulimi. Sistem i mbyllur me vakum” dhe “2. Tuba me xhel për serum me aktivator koagulimi të shpejtë. Sistem i mbyllur me vakum”?* Në lidhje me tubin e dytë, a është ky tub për aktivizues mpiksje trombine?”.

Në datën 07.10.2021, autoritetit kontraktor ka kthyer përgjigje në lidhje me kërkesën e mësipërme, ku informon se, *“Në lidhje me pikën e parë të kërkesës tuaj për sa i përket dallimit mes dy produkteve të mësipërme, ju bëjmë me dije se referuar edhe në specifikimet teknike (shtojca 5) të përcaktuara në DST për këtë procedurë prokurimi në tabelën përkatëse për këto dy artikuj (tek shënimet) dallimi thelbësor mes tyre qëndron tek koha e koagulimit, ku të njëra është jo më shumë se 30 minuta dhe tek tjetra jo më shumë se 10 minuta (koagulimi i shpejtë), pasi kjo ndikon në kohën e realizimit të analizave urgjente të një kohe më të shkurtër. Në lidhje me tubin e dytë me aktivator koagulimi të shpejtë ju bëjmë me dije se aktivizuesi mund të jetë çdolloj aktivizuesi i cili bën koagulimin në jo më shumë se 10 minuta.”*

III.1.11. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) nga operatori ekonomik “Almedical” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur Katalogun “Vacusera” me prodhues Disera në Turqi, ku rezulton se për artikullin nr. 2 të përcaktuar në Shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike” të dokumenteve të tenderit, *“Tuba me xhel për serum me aktivator koagulimi të shpejtë. Sistemi i mbyllur me vakum. Tapë e verdhë/kuqe”*, do të ofrohet produkti “Vacusera 5 ml CAT Serum GEL and Thrombin”, me shtues Gel + Aktivizues mpiksje + Trombine, me ngjyrë portokalli. Gjithashtu, konstatohet se për këtë artikull, nga ankimesi është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor mostër nga prodhuesi Disera “tub me xhel me aktivizues koagulimi dhe trombine”, me tapë ngjyrë portokalli, ngjyrë kjo e cila është arsye skualifikimi nga autoriteti kontraktor për operatorin ekonomik “Almedical” SHPK.

KPP nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik “Almedical” SHPK, pretendimeve dhe argumenteve të paraqitura nga ky i fundit bashkëlidhur ankesës së tij, si dhe korrespondencës dhe informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, si organi kombëtar i standardizimit në Republikën e Shqipërisë, gjykon se, referuar aneksit F të standardit SSH EN ISO 6710:2017, ngjyra e tubit për aktivizues koagulimi me xhel rekomandohet ngjyra e verdhë e errët, por po në këtë përcaktim sqarohet se, për aktivizues mpiksje trombine rekomandohet ngjyra portokalli.

Për më tepër, Komisioni i Prokurimit Publik, me qëllim gjykimin mbi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për shqyrtimin e ankesës së ankimesit, iu drejtua autoritetit kontraktor me një kërkesë për informacion (si më lart cituar), ku ky i fundit me anë të shkresës nr. 2178/13 prot. datë 05.10.2021, protokolluar me tonën me nr. 1491/11 prot., datë 07.10.2021,

informon se: “Në lidhje me tubin e dytë me aktivator koagulimi të shpejtë ju bëjmë me dije se aktivizuesi mund të jetë cdo lloj aktivizuesi i cili bën koagulimin në jo më shumë se 10 minuta”. Pra, sa më sipër, vetë autoriteti kontraktor sqaron, se pranohet çdo lloj aktivizuesi i cili bën koagulimin në jo më shumë se 10 minuta. Në rastin konkret, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur një tub me xhel me aktivizues koagulimi dhe trombine, e rrjedhimisht në raste të tilla, referuar standardit SSH EN ISO 6710:2017, ngjyra e tapës së tubit duhet të jetë portokalli.

Në përfundim, sa më sipër analizuar, nga verifikimi i dokumentacionit dhe mostrave të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues, argumenteve të autoritetit kontraktor, si dhe në mbështetje të korrespondencës me institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, si organi kombëtar i standardeve në Republikën e Shqipërisë, KPP gjykon se, duke qenë se operatori ekonomik “Almedical” SHPK, referuar katalogut dhe mostrave të dorëzuara, vërteton se do të ofrojë në këtë procedurë prokurimi produktin “*tub me xhel me aktivizues koagulimi dhe trombine*”, për sa kohë që autoriteti kontraktor sqaron, se do të pranohet çdo lloj aktivizuesi, rrjedhimisht produkti i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues me tapë ngjyrë portokalli është i saktë dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në këto kushte, edhe pse autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për artikullin e mësipërm nuk ka përfshirë edhe ngjyrën e tapës “portokalli”, si specifikim teknik, por për sa kohë operatori ekonomik “Almedical” SHPK vërteton, se ka dorëzuar mostër për artikullin nr.2 “*Tuba me xhel për serum me aktivator koagulimi të shpejtë. Sistemi i mbyllur me vakum. Tapë e verdhë/kuqe*”, në përputhje me standardin ndërkombëtar EN ISO 6710:2017, rrjedhimisht arsyeja e skualifikimit të tij nuk qëndron.

Vlen të theksojmë se, në respekt të parimeve të ligjit për prokurimin publik, specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë /përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Një ndër këto metoda, është mbështetja në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike

kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Almedical” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-98424-06-17-2021, me objekt: “Blerje tuba dhe materiale konsumi për marrjen e kampionëve të gjakut për nevoja të QSUNT për 12 muaj”, me fond limit 15.941.052,5 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 15.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
  2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Almedical” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
  3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Almedical” SHPK.
  5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Florent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**